Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**11.01.2024**	**29.01.2024**	**2024/0026**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.01.2024, **OE "N.T.P "HAJDINI COMERC ""- Prishtin**ë, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0026**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **GOE "Global Parajsa SHPK & Delfini LTD"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sherbimet me ushqim (furnizim, pergatitje dhe servim) ne kazermat Prishtine, Gjilan, Mitrovice, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakove, Prizren" per nevoja te FSK-se, LOT 1. Sherbimet me ushqim (furnizim, pergatitje dhe servim) kazerma ne Prishtine me nr. të prokurimit: "217-23-5070-2-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E MBROJTJES**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës**: Pjesa 1: 3,340,000 €;**

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më **Nr. 2023/0768 i dt:22.11.2023.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Të pa kënaqur me Vendimin e Autoriteti kontraktues – MINISTRIA E MBROJTJES dhe në pajtim me nenin 109 të LPP-së parashtrojmë ANKESË kundër;

-Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 27.12.2023;

- Njoftimit B58, Njoftim mbi Vendimit te AK te datës 20.12.2023

Pretendojmë se MINISTRIA E MBROJTJES, përmes Zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

-Neni 1, Qëllimi, par 1,2 dhe 3;

-Neni 4.1.26, Palë e interesuar;

- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1 dhe 2;

-Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi par 6;

- Neni 27/A, Ndarja e kontratave në Lote, par 1 dhe 2;

- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve par 4;

-Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1;

- Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, par 8, nen par 8.4 dhe par 12

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Neni 18, Ndarja e kontratave në Lote, par 18.8

III. Mos respektim të vendimit të OSHP-se, Nr. 2023/768 i datë 22.11.2023

Ne vijim do ti trajtojmë pretendimet tona ne ANKESË duke e kundërshtuar :

Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 27.12.2023;

Zyrtari përgjegjës i Autoriteti Kontraktues, ne kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 108/A, paragrafit 8, nen paragrafit 8.4 dhe paragrafit 12 të LPP-se, refuzon kërkesën pa i shqyrtuar pretendimet tona dhe pa i arsyetuar e argumentuar ato, pra, Arsyetimi i AK është në kundërshtim me DISPOZITIVIN, sepse nuk ka ofruar as një arsyetimi në lidhje me pretendimet tona të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim por në mënyre gjithëpërfshirëse pa substancë dhe pa përmbajtje, si në vijim:

E para: AK nuk ka ofruar as një kundër argument apo arsyetim ligjor sa i përket pretendimit tone, në rastin kur shpërblen me kontratë GOE : NTP "Global Parajsa" & "Delfin" LTD shpk me çmim prej 3,998,750.00€, kurse konsorciumi ynë për këtë Lot ka ofruar çmimin me te ulët në shume prej 2,795,000.00€, pra kemi një diferencë prej 1,203,750.00€, apo në përqindje rreth 43%, e që në rastin konkret kemi të bëjmë me dëmtim të buxhetit nga ana e AK. Dhe,

rrjedhimisht me ketë veprim AK, ka bërë shkelje eklatante të dispozitave të nenit 6, paragrafit 1, të LPP-së, për faktin se, AK, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, por që ne rastin konkret AK ka shkelur dispozitat në fjalë sepse bëhet fjalë për dëmtim të parasë publike, madje nuk ka dhëne asnjë arsyetim në pretendimin tonë të ngritur në kërkesën për rishqyrtim, prandaj, me të drejtë konsiderojmë se refuzimi i AK është i pa drejtë, diskriminues, ne shkelje të ligjit dhe i pa qëndrueshëm!

E dyta: AK nuk ka ofruar as një kundër argument apo arsyetim ligjor sa i përket pretendimit tone, në lidhje me tejkalimin e buxhetit për Lot1 nga ana e GOE : NTP "Global Parajsa" & "Delfin" LTD, për faktin se GOE në fjalë ka ofruar çmimin prej 3,998,750.00€, kurse AK për ketë Lot ka planifikuar buxhet: 3,340,000.00€, pra është për 658,750.00€ apo rreth 20% , tejkalim i buxhetit të planifikuar nga e AK. Dhe, rrjedhimisht GOE në fjalë do të duhej të trajtohej i pa përgjegjshëm edhe në ketë fazë, siç kishte vepruar AK ne fazën fillestare, ku me anë të njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 19.09.2023 OE e trajton të pa papërgjegjshëm me arsyetimin se Oferta e GOE është shume me e lartë sesa buxhetit i planifikuar i AK.

Kurse në ketë fazë të ri-vlerësimit të Ofertave, GOE në fjalë pa qenë palë me interes, AK, përkundër njoftimit mbi vendimin e AK të datës 19.09.2023, kur, GOE në fjalë, e trajton të pa përgjegjshëm, për shkak të tejkalimit të buxhetit të AK, tani në ketë fazë e trajton të përgjegjshëm, madje, nxjerr tjetër njoftim mbi vendimin e AK, meqë rast e favorizon tej mase dhe e shpërblen edhe me kontratë për Lot-in në fjalë.

Prandaj, në ketë rast, AK, shkel dispozitat e nenit 6, paragrafit 2, sepse fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës, por që AK, tejkalon kompetencat ligjore sepse shpërblen me kontratë GOE, edhe pse, oferta e tyre ka tejkaluar buxhetin e planifikuar të AK rreth 20%. Dhe, rrjedhimisht, referuar sqarimeve të lartë cekura, pretendojmë se zyrtaret përgjegjës të AK kanë shkelur dispozitat e nenit 1 qëllimin, paragrafin 1, 2 dhe 3, dispozitat e nenit 6, paragrafin 1 dhe 2, të LPP-se, për faktin se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me veprime të cilat AK do ti shkaktojnë dëme të pa riparueshme duke e dëmtuar rendë buxhetin e AK, nëse, një kontratë e tillë nënshkruhet nga ana e AK, sepse GOE në fjalë nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm, për me tepër ka çmim dukshëm me te lartë se konsorciumi yne rreth 40% me çmim me te lartë dhe, po ashtu ka ofruar çmim rreth 20% mbi buxhetin e planifikuar të AK. Prandaj, me te drejtë, konsiderojmë se refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK, është i pa drejtë, diskriminues, ne shkelje të ligjit dhe si i tillë është i pa qëndrueshëm!

E treta, por jo nga ma e pa rëndësishmja, AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse GOE NTP "Global Parajsa" & "Delfin" LTD, nuk mund të konsiderohet palë me interes në ketë aktivitet, për faktin se GOE në fjalë, nuk i ka shfrytëzuar rrugët ligjore që i jap Ligji i Prokurimit Publik, për të parashtruar kërkese për rishqyrtim apo Ankesë ne OSHP gjatë fazës fillestare, kur, AK me anë të njoftimit B58, mbi vendimin e AK të datës 19.09.2023, anulon në tersi aktivitetin në fjalë dhe rrjedhimisht edhe Lot 1, sepse, në ketë rast dhe me ketë vendim për anulim të aktivitetit në fjalë, GOE është trajtuar i pa përgjegjshëm dhe, për me tepër GOE në fjalë është pajtuar me vendimin e AK për çka edhe nuk ka

parashtruar kërkese për rishqyrtim ne AK apo Ankesë ne OSHP, prandaj, nuk mund të konsiderohet palë me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-se.

Sepse, te vetmit palë me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së, është konsorciumi ynë: Nnh "Verona" & Ntp "Hajdini Comerc" & Bylmeti-Ks Shpk, për shkak se kanë shfrytëzuar rrugët ligjore që i jep ligji i prokurimit Publik, duke parashtruar kërkese për rishqyrtim ne AK dhe ankese OSHP ne fazën fillestare, kundër njoftimit B58, mbi vendimin e AK të datës 19.09.2023, kur anulon aktivitetin në tersi, gjë që OE pjesëmarrës në ketë aktivitet, nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Madje, ky pretendim i ynë mund të dëshmohet përmes vendimit të OSHP-së Nr. 2023/768 i datë 22.11.2023, kur OSHP, e konsideron palë me interes konsorciumin tonë, sepse te vetmit kandidat potencial me çmimin me te ulët dhe brenda buxhetit të planifikuar të AK, për shpërblim me kontratë është konsorciumi ynë.

Në lidhje me këtë dhe, referuar sqarimeve të lartë cekura edhe pse aktiviteti i prokurimit ka qenë i ndarë në Lot-pjesë heterogjene sipas dispozitave të nenit 27/A të LPP-se, AK, mund të shpërblej një tenderues me shume Lot-pjesë sesa numri maksimal, sepse ne rastin konkret nuk kemi OE tjerë të përgjegjshëm, për faktin se kanë ofruar çmime mbi buxhetin e planifikuar të AK. Dhe, rrjedhimisht, po ti referohemi edhe dispozitave të neni 18, paragrafit 18.8 të rregullores 001/2022 për Prokurim Publik. AK, ruan të drejtën që, në rast se, ka kufizim të numrit të Lot-ve por nuk ka tender të përgjegjshëm të mjaftueshëm për të shpërblyer të gjitha Lot-et, atëherë mbizotëron interesi i AK që të shpërblej të gjitha pjesët. Pra, në mungesë të konkurrentëve të tjerë, OE shpërblehen për më shumë Lot-e se sa numri maksimal i përcaktuar nga AK duke u shpërblyer OE me Lot-et për të cilat kanë ofruar ofertën më të ulët, e që në rastin konkret konsorciumi ynë ka ofruar çmimin me te ulët në të dy Lot-et e shpallur nga AK.

Prandaj, në rastin konkret, kemi trajtim jo të barabartë ne ketë aktivitet, nga ana e AK, sepse kemi te bëjmë me shkelje të nenit 7, paragrafët 1, 2 dhe 6 i LPP-se, ku ndër të tjera, garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, sepse i tërë qëllimi i normës së mësipërme është sigurimi i barabarësisë në trajtim të operatorëve ekonomik në mënyre barbaret dhe jo diskriminuese.

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej te drejtave themelore të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë.

Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëllojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret.

Sidoqoftë, në asnjërën nga këto momente nuk u veprua konform legjislacionit në fuqi, kështu, GOE: NTP "Global Parajsa" & "Delfin" LTD shpk, mbeti në garë edhe në procedurën e ri-vlerësimit, përveç se kësaj here tejet më i favorizuar, madje pa qenë palë me interes, për me tepër, mbi 43% të çmimit me të lartë mbi çmimin e konsorciumit tonë dhe rreth 20% të çmimit me te lartë sesa buxheti i planifikuar i AK. Madje, diferenca në çmim ne raport me konsorciumin tonë mbi 43%, apo në vlerë financiare 1,203,750.00€, konsiderohet dëmtim i rëndë i buxhetit, sepse i terë qëllimi i LPP-së, është vlera për para ma kosto sa me ekonomike.

Prandaj, bazuar në ketë faktet e lartë përmendura, pretendimet tona janë të qëndrueshme dhe, rrjedhimisht GOE në fjalë do të duhej te shpallej i pa përgjegjshëm, për shkak të tejkalimit buxhetit të AK, sepse, është në kundërshtim te plotë me dispozitat nenit 9, paragrafit 2, sa i përket vlerësimit i nevojave dhe arsyetimit të ushtrimit të aktivitetit të prokurimit, si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 60, par 1, nen par 1.1, sa i përket kritereve të vlerësimit të parapara në njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit, për faktin se jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët.

Kurse, sa i përket Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 20.12.2023, qëndrojmë prapa kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar në AK të cilën e kemi argumentuar dhe e cila është pjese e bashkangjitur në ketë ankesë.

Prandaj, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga OSHP-ja, të nxjerr:

VENDIM

-Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të **aprovoj ANKESEN** të bazuar të paraqitur nga **GOE Nnh "Verona" & Ntp "Hajdini Comerc" & Bylmeti-Ks Shpk**.

-Te anuloj vendimin e AK – MINISTRIA E MBROJTJES, për refuzim të kërkesës për Ri-shqyrtim, sepse GOE Nnh "Verona" & Ntp "Hajdini Comerc" & Bylmeti-Ks Shpk, kanë dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

-Te kthej rastin ne **Ri-Vlerësim për Lot 1:** Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë, duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm **GOE Nnh "Verona" & Ntp "Hajdini Comerc" & Bylmeti-Ks Shpk,** për faktin se ka ofruar çmimin me te ulët dhe brenda buxhetit të planifikuar të AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

Ndarja ne Lote	2.5	Ndarja ne Lote: Po ☒ Objekti i kontratës është i ndare në [3] pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender [për një apo më shumë pjesët (lote)]. Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionit teknike, shih Aneksin 1, dhe ofertës **financiare Pjesa II. Lista e çmimeve.** NUMRI MAKSIMAL I PJESËVE QË DO TË MUND TË SHPËRBLEHEN TEK NJË TENDERUES ËSHTË: 1 Rregullat për shpërblimin e lotëve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kritereve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi, nëse tenderuesi dorëzon tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët me në më shumë se tre pjesë sa është numri maksimal i pjesëve që mund të shpërblehet një tenderues, atëherë AK do të shpërblej OE për LOT-in më të favorshëm për AK sipas nenit 18.7 të rregullores 001/2022 për Prokurim Publik. Ndërsa me pjesët tjera do të shpërblehen tenderuesit që janë radhitur me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Tenderuesi do të shpërblehet duke filluar me renditje nga vlera më e lartë e parashikuar për pjesë te vlerat më të ulëta të parashikuara për pjesë Njoftim: Sipas nenit 18.8 të rregullores 001/2022 për Prokurim Publik. AK- ruan të drejtën se ne rast se nuk pranon oferta te përgjegjshme për ndonjë LOT atëherë do te shpërblehet me shumë LOT-e se një pjese . Shembull : Ne rast se kemi shpërblye një OE me një pjese, mirëpo për lotët tjera nuk kemi as një ofertë te përgjegjshëm AK – do te vazhdoj me shpërblim te OE te njëjte edhe ne LOT-et tjera ne rast se është i përgjegjshëm

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

Bazuar ne vendimin e OSHP-së me numer 2023/0768 te dates 22.11.2023, Komisioni për Ri-vlerësim krahasim dhe ekzaminim te tenderëve përfundimit te procesit te Ri-vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave në aspektin e përshtatshmërisë formale/administrative; pranueshme pranueshmerisë profesionale; të kritereve mbi gjendjen ekonomiko financiare; si dhe lidhur me aftësinë teknike dhe/ose profesiona përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, si dhe duke marrë për baze analizat, sqarimet, opinionet profesionale të janë cekur në "Procesverbal" dhe analizën e çmimeve për LOT-in më të favorshëm për AK sipas nenit 18.7 të rregullores 001/2022 Prokurim Publik, njëzëri konstaton se:

LOT - 1. . Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. ' GLOBAL PARAJSA '; Delfin L.t.d. SH.P.K - ka plotësuar minimumin e kërkes përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe në përputhje me kriteret për dhënie të kontratës e rekomandojmë për dhë kontratës, sepse edhe pse ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lartë për këtë Lot prej **3,998,750.00 €,** duke u bazuar në krit DT dhe Njoftimin për kontratë se një OE mund të shperblehet vetëm më një LOT, ateherë kjo ofertë rezulton te jetë çmimi ekonomikish favorshëm për AK-në.

LOT 1 ka tejkalim nga buxheti i mjete të planifikuara sipas "Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve **20%**, ose **658,750** euro, mirëpo pas kalkulimeve për çmimin e pëgjithshëm më të favorshëm del kombinimi më i favorshëm dhe me i li AK-në për ta ruajtur buxhetin e AK-së.

LOT - 2. Grup i Operatorëve Ekonomik NNH,, Verona ; N.T.P HAJDINI COMERC ; BYLMETI - KS - ka plotësuar minimu kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe në përputhje me kriteret për dhënie të kontratës e rekoman për dhënie të kontratës për LOT 2, sepse ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më i lirë për AK-në ne vlere prej **4,247,100.00 €.**

LOT - 3. Beni Dona Plast SH.P.K. - ka plotësuar minimumin e kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë d përputhje me kriteret për dhënie të kontratës e rekomandojmë për dhënie të kontratës për LOT 3, sepse ka ofruar ofertën e përgjegjshr çmimin më të lirë për AK-në prej **3,914,750.00€.**

Për këtë projekt, të planifikuara sipas "Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve" sipas Nenit 9 të Ligj 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligji 05/L-092, për tre vite kanë qenë 13,000,000.00 € të ndara në LOT-e si në vijim:

Pjesa 1: 3,340,000.00 €; Pjesa 2: 5,280,000.00 €; Pjesa 3: 4,380,000.00 €;

Andaj bazuar në këtë që u tha më lartë kërkojmë nga ju që të veproni më tutje në përputhje me legjislacionin në fuqi, Ligjin nr. 04/L-042 pë Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 legjislacionit sekondar në fuqi.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **N.T.P "HAJDINI COMERC "**

Aktiviteti i prokurimit me titull: **"Sherbimet me ushqim (furnizim, pergatitje dhe servim) ne kazermat Prishtine, Gjilan, Mitrovice, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakove, Prizren" per nevoja te FSK-se, LOT 1. Sherbimet me ushqim (furnizim, pergatitje dhe servim) kazerma ne Prishtine me nr. të prokurimit: "217-23-5070-2-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E MBROJTJES**, ka fillur me njoftimin për kontrate me datë 01.06.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 14.07.2023, njoftimi B58 rivlerësim publikohet me datë 20.12.2023.

OE ankuesi është i rekomanduar për kontratë **për LOT 2**, kurse i pa kënaqur me njoftimin për rekomandim **B58 -LOT 1 – GOE Global Parajsa & Delfin LTD**, atëherë parashtron ankesë në OSHP kundër GOE të rekomanduarit.

Tutje, i njëjti në ankesë pretendon se AK nuk ka vlerësuar ofertat konform LPP_së gjegjësishtë ka shkelë nenet 1, 4.1.26, 6 par. 1 dhe 2, 7 par.6, 27/A par.1 dhe 2, 59 par.4, 60 par. 1, 1.1, 108/A par.8, 8.4, 12;

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Neni 18, Ndarja e kontratave në Lote, par 18.8

III. Mos respektim të vendimit të OSHP-se, Nr. 2023/768 i datë 22.11.2023

** Fillimisht, OE ankuesi pretendon se GOE i rekomanduar është palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit, sepse pas vlerësimit të parë nuk ka parashtruar kërkesë në AK/Ankesë në OSHP.*

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin sqaron se, AK pas pranimit të vendimit 768/23 të datës 22.11.2023 ka vazhduar me rivlerësim të të gjitha ofertave, pra ka kthyer aktivitetin e prokurimit në pikën zero.

** OE ankuesi pretendon se AK ka rekomanduar një OE i cili tejkalon buxhetin mbi 20 % të vlerës së parashikuar.*

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin sqaron se, AK në këtë aktivitet të prokurimit ka iniciuar kontratë publike kornizë për 36 M, e cila konform nenit 38 të LPP_së, AK mund të aplikoj +/- 30 % nëse ka mospërputhje, **andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.**

** OE ankuesi pretendon se AK ka rekomanduar një GOE i cili është më i shtrenjtë se oferta jonë, mbi 43%.*

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin sqaron se, pas analizimit të listës sqarojmë se, OE ankuesi është më i lirë se sa GOE i rekomanduar, **andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Si përfundim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. **LOT 1.** Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. **LOT 2**. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. **LOT 3**. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren**me nr. të prokurimit: "217-23-5070-2-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **– MINISTRIA E MBROJTJES**, fillimisht vlen të theksohet se AK në vlerësimin e parë ka publikuar vendimin B58 Njoftim mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit kundër dispozitave ligjore të LPP-së, mirëpo me vendimin e panelit shqyrtues me nr.**2023/0768 të datës 22.11.2023,** AK është detyruar që të kthej lëndën në rivlerësim, ku pastaj në proces të rivlerësimit janë rekomanduar për kontratë në tri lote, tre operator ekonomik:

LOT 1: NTP"Global Parajsa & Delfin SHPK

LOT 2: NNH "Verona & NTP Hajdini Commerce & Bylmeti SHPK

LOT 3: "Beni Dona Plast" SHPK

Tutje, në vendimin e publikuar B58-Rivlerësim, të lartpërmendurit pas refuzimit të kërkesave për rishqyrtim nga AK, janë ankuar në OSHP me numrat e lëndëve 2024/008, 2024/018, 2024/026, të cilët kanë parashtruar pretendime ankimore kundër njëri tjetrit.

Gjerësa, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të ofertave me kërkesat e AK-së, si rrjedhojë sipas sqarimeve në shqyrtimin e pretendimeve ankimore në lëndët me raporte **8/24 18/24 dhe 26/24**, rezultojnë se, tre GOE të rekomanduarit për tri lote janë të pa përgjegjshëm dhe nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit të përcaktuara nga AK- Ministria e Mbrojtjes.

Andaj, konsideroj se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet konform Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 **neni 43.5 pika b.**

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E MBROJTJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.T.P "HAJDINI COMERC "**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELOZA RAZMATRIMI I NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Blerina Hurugllca